



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Memorandum Mirëkuptimi

ndërmjet

Këshillit Gjyqësor të Kosovës

dhe

Ministrisë së Administratës Publike

për

**bartjen e fondeve dhe projekteve kapitale në lidhje me ndërtim dhe
renovim të objekteve nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Ministrinë e
Administratës Publike**

Neni 1 **Qëllimi**

1.1 Ky memorandum mirëkuptimi ka për qëllim bartjen e fondeve dhe projekteve kapitale në lidhje me ndërtim dhe renovim të objekteve nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (tani tutje: KGJK) duke u bazuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës në Ministrinë e Administratës Publike (tani tutje: MAP) duke u bazuar në Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Shtojca 11 pika (vii).

1.2 Bartja e këtyre projekteve në MAP ka për qëllim realizimin sa më të shpejt dhe efikas të tyre duke pasur parasysh kompetencat dhe përgjegjësitë e Ministrisë përkatëse lidhur me administrimin e objekteve dhe institucioneve publike si dhe qëllimin e krijimit të Agjencisë qendrore për inxhiniering dhe menaxhimin e pasurisë shtetërore i cili parashihet me Programin Legjislativ të vitit 2015.

Neni 2 **Përgjegjësitë e KGJK**

2.1 KGJK merr për obligim që të transferojë kodet e projekteve me mjetet e nevojshme buxhetore me rishikim buxhetor në kodin dhe buxhetin e MAP-se dhe atë projektet si në vijim :

1. Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Gjakovë:
 - a. *kodi i projektit 328461 - 1213920,*
 - b. *vlera për vitin 2015: 720,000.00€, 2016 : 1,220,000.00 € dhe 2017, ... €.*
2. Dizajnimi i projektit, dhe ndërtimi i objektit të degës së gjykatës në Novobërdë:
 - a. *kodi i projektit 328461 - 1214394,*
 - b. *vlera për vitin 2015: 100.000.00€, 2016: 100.000.00 € dhe 2017: 250.000.00€.*
3. Dizajnimi i projektit, dhe ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore Pejë:
 - a. *kodi i projektit 328461 - 1213900,*
 - b. *vlera për vitin 2015: --- €; 2016: 100.000.00€ dhe 2017: 320.000.00€*

2.2 KGJK pajtohet të bëjë edhe transferimin e stafit përkatës (dy inxhinierëve) nga KGJK në MAP.

2.3 KGJK do të bëjë pagesën për projektet deri sa të transferohen të gjitha kodet dhe mjetet buxhetore tek MAP.

Neni 3 **Përgjegjësitë e MAP**

3.1 MAP merr për obligim që t'i udhëheq të gjitha procedurat e prokurimit , menaxhimit dhe mbikëqyrjes së këtyre projekteve konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

3.2 MAP do të merr për bazë udhëzimet dhe këshillat e KGJK në lidhje me prioritetet dhe natyrën e investimeve si gjatë ashtu edhe pas realizimit të projekteve të parapara me kornizë afatmesme të shpenzimeve të cekura në nenin 2.1 të kësaj marrëveshjeje mirëkuptimi. Gjatë pranimit të punëve, MAP do të emërojë në përbërje të komisionit të pranimit edhe një zyrtar të caktuar nga KGJK.

Neni 4 Pranim-dorëzimi

4.1 Drejtori i Sekretariatit të KGJK-së dhe Sekretari i MAP-it do të formojnë komisione përkatëse profesionale për bartjen, pranim dorëzimin e të gjitha materialeve në lidhje me projektet. Pranim-dorëzimi i të gjithë materialit do të përfundojë jo më larg se 10 (dhjetë) dite nga dita e nënshkrimit të këtij Memorandumi.

4.2 Komisionet përkatëse të parapara në nenin 4 do të hartojnë procesverbale mbi bartjen, pranim dorëzimin e të gjitha dokumentacioneve – dosjeve të nevojshme.

Neni 5 Menaxhimi i objekteve

MAP pas përfundimit të projektit, objektin e dorëzon tek përfituesi i cili e merr përsipër menaxhimin e objektit.

Neni 6 Zbatimi

Ky memorandum paraqet vullnetin e mire të palëve nënshkruese dhe të njëjtit zotohen se do ta zbatojnë brenda një periudhe sa më të shkurtër kohore në pajtim me ligjet në fuqi .


Neni 7 Periudha kalimtare dhe përfundimtare

7.1 Pas realizimit të investimeve kapitale baza e të cilave është vendosur në ndërtimin e objekteve të gjykatave, mjete buxhetore të parapara për këtë qëllim do të kthehen tek buxheti i KGJK për të bërë ri-destinimi e këtyre mjeteve sipas nevojave të gjyqësorit të Kosovës.

7.2 Ky Memorandum Mirëkuptimi është i përpiluar në tri kopje për secilën palë nënshkruese nga një kopje dhe një kopje i dërgohet Ministrisë së Financave.

7.3 Ky memorandum hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit të tij.

Palët nënshkruese



Prishtinë, 25.03.2015 2015

